



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 14 datë 08/02/1996

**PER  
DHENIE FOND KONSERVIMI FABRIKES RERE SHTUFIT  
SHKOZE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.08.02.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës për dhënien e një fondi konservimi në Fabrikën e Rërë Shtufit Shkozë, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.158, dt.11.04.1994, pika.a,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e fondit të konservimit për vitin 1995.
2. Dhënia e fondit të konservimit për aq kohë që kjo ndërmarrje do të shpallet në gazetë për privatizim. Fondi mujor të jepet për ruajtjen e ndërmarrjes. Vlera e fondit mujor të jetë 35.369 lekë vetëm për 5 rojet (ndër to dhe një përgjegjës).

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**